

D. KONTAKTE TË RËNDËSISHME

Të poshtëshënuara mund të gjeni informatat mbi institutet ndërkombëtare dhe organizatat në fushën e të drejtave të njeriut dhe të arsimimit mbi të drejtat e njeriut. Shumica e tyre prodhojnë materiale të të drejtave të njeriut, mbajnë (simulime praktike) urokshope dhe ofrojnë informata dhe këshilla mbi të drejtat e njeriut.

ORGANIZATAT

Organizatrat Ndërkombëtare

Kombet e Bashkuara (KB)

UN Headquarters

First Avenue at 46th Street

Neë York, NY 10017;

USA

Adresa e internetit: www.un.org

E-mail: inquiries@un.org

Faqja e internetit e KB përmban të gjitha informatat për organizatat e specializuara apo të nënspecializuara të poshtëshënuara. Prandaj ne kemi ofruar listën me institucionet më të rëndësishme në fushën e të drejtave të njeriut dhe të arsimimit për të drejtat e njeriut.

Zyra e Komisionerit të lartë për të Drejta të Njeriut të Kombeve të Bashkuara [ZKLDNKB (OHCHR-UNOG)]

OHCHR-UNOG

8-14 Avenue de la Paix 1211 Geneva 10,

Switzerland,

Europe

Telephone Number: + 41 22 917 9000

Adresa e internetit: <http://www.unhcr.ch/>

E-mail: shih:

<http://www.unhcr.ch/html/hchr/contact.htm>

Gjuhët e punës: angleze, frënge dhe spanjolle

Lloji i programeve: zhvillimi i planeve të veprimeve nacionale, mbështetje për OJQ-të, trajnimi për grupe të ndryshme profesionale, raportimi për traktate dhe obligimet ndërkombëtare, zhvillimi i kurrikulës etj.

Grupet e synuara: ligjvënësit, gjykatësit, avokatët, prokurorët, policët, zyrtarët e burgjeve, mësuesit, zyrtarët qeveritarë, mediat, shërbyesit civil

Baza e të dhënave ofron informatë mbi organizatat, materialet dhe programet për arsimimin mbi të drejtat e njeriut. Baza e të dhënave përbën kontributin e saj për Dekadën e Kombeve të Bashkuara mbi Arsimimin për të Drejtat e Njeriut (1995-2004), lehtëson ndarjen e informatave në shumë burime që janë në dispozicion në fushën e arsimimit dhe trajnimi të të drejtave të njeriut. Pesë seksionet mund të hulumtohen nga një fokus gjeografik, grupet e synuara, fokusi substancial, vendi/regjioni, lloji dhe gjuha. Informatat që janë në bazën e të dhënave janë në anglisht, frëngjisht dhe spanjisht.

Organizatat e Kombeve të Bashkuara për Arsimim, Shkencë dhe Kulturë [(OKBASHK) UNESCO]

UNESCO

7, Place de Fontenoy

75352 PARIS 07 SP,

France, Europe

Numri i telefonit: + 33 1 45 68 10 00

Adresa e internetit: www.unesco.org

E-mail: geneva@unesco.org

Gjuhët e punës: frëngjisht, anglisht

Llojet e programeve: Politikbërja e ADN, botime; kujdesja për të drejtat e njeriut dhe rrjetet e hulumtimit të ADN; ADN në shkollat e mesme; trajnimi i grupeve profesionale (parlamentarëve, politikanëve lokalë, përfaqësuesve të OJQ-ve); ADN në nivel universal

Grupet e synuara: nivelet e shkollave të mesme dhe universitetet; grupet profesionale.

Qëllimi kryesor i UNESCO është që të kontribuojë për paqe dhe siguri në botë, duke promovuar bashkëpunimin ndërmjet kombeve përmes arsimit, shkencës, kulturës dhe komunikimit në mënyrë që të përparojë respektin e përgjithshëm për drejtësi, për

sundimin e ligjit dhe për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të cilat janë të konfirmuara nga popujt e botës, pa ndonjë ndasi në racë, seks, gjuhë apo religjion, sipas Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Komisioneri i Lartë për Refugjatë i Kombeve të Bashkuara (KLRKB – UNHCR)

United Nations High Commissioner for Refugees

Case Postale 2500

CH-1211 Genève 2 Dépôt

Suisse, Europe

Numri i telefonit: +41 22 739 8111

Adresa e internetit: www.unhcr.ch

E-mail: twole@unhcr.ch

Gjuhët e punës: frëngjisht, anglisht

Llojet e programeve: arsimi publik; fushatat për vetëdijësim publik; zhvillimi i taksave

Grupet e synuara: mësuesit; refugjatët; agjencitë qeveritare

Zyra e Komisionerit të Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara, ka mandat që të udhëheqë dhe të koordinojë veprimet ndërkombëtare për mbrojtjen e refugjatëve dhe që t'i zgjidhë problemet në të gjithë botën. Qëllimi i saj primar është që t'i ruajë të drejtat e mirëqenies së refugjatëve. Ajo përpiqet të sigurojë se çdonjëri mund të ushtrojë të drejtën për kërkim të azilit dhe të gjejë strehim në një shtet tjetër, me mundësinë e kthimit në shtëpi vullnetarisht, që të integrohet në mënyrë lokale apo të rivendoset në një shtet të tretë.

Fondi i Fëmijëve i Kombeve të Bashkuara (FFKB- UNICEF)

UNICEF House (adresa postare)

3 United Nations Plaza

New York 10017

New York, U.S.A.

Numri i telefonit: +1 212 326 7000

Adresa e internetit: www.unicef.org

E-mail: info@unicef.org

Gjuhët e punës: frëngjisht, anglisht, spanjisht

UNICEF ka mandat nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara që të avokojë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të ndihmojë që të plotësohen nevojat themelore dhe të zgjerojnë shanset e tyre në mënyrë që të arrijnë potencialin e tyre të plotë. UNICEF udhëhiqet nga Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës dhe përpiket që të themelojë të drejtat e fëmijëve si parime të qëndrueshme etike dhe standarde ndërkombëtare të sjelljes kundrejt fëmijëve.

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP – ILO)

International Labour Office

4, route des Morillons

CH-1211 Geneva 22

Switzerland, Europe

Numri i telefonit: +41 22 799 6111

Adresa e Internetit: www.ilo.org

E-mail: ilo@ilo.org

Gjuha e punës: angleze

Organizata Ndërkombëtare e Punës është një agjencion i specializuar i Kombeve të Bashkuara, e cila kërkon shtytjen e drejtësisë sociale në të drejtat e njohura ndërkombëtarisht të drejtave njerëzore të punës. ONP formulon standarde ndërkombëtare të punës në formë të konventave dhe rekomandimeve, duke krijuar standarde minimale për të drejtat themelore të punës. Ajo promovon zhvillimin e organizatave të punëdhënësve dhe punëtorëve të pavarura dhe ofron trajnime dhe shërbime të këshillimit për këto organizata.

Organizatrat rajonale

Afrika

Komisioni Afrikan mbi të Drejtat e Njeriut dhe Njerëzve (KADNN- ACHPR)

Kairaba Avenue, P.O. Box 673 Banjul, The Gambia

Tel (220) 392 962

Fax (220) 390 764

Adresa e internetit: www.achpr.org

E-mail: achpr@achpr.org, idoc@achpr.org

Gjuhët e punës: anglisht dhe frëngjisht, po ashtu edhe arabisht dhe spanjisht
Komisioni Afrikan mbi të Drejtat e Njeriut dhe Njerëzve KADNN është institucioni kryesor i sitemit afrikan të të drejtave të njeriut. Detyra kryesore e tyre është shtytja dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut. Në fushën e shtytjes ajo shpërndan informatat mbi sistemin e të drejtave të njeriut në Afrikë dhe organizon seminare dhe konferenca. Në fushën e mbrojtjes ajo pranon “komunikim” nga individët dhe grupet që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e njeriut. Selia e saj është në Banjul, Gambi. Është një organ i unionit Afrikan dhe ish organizatës së shteteve afrikane. Pas hyrjes në fuqi të protokolit fakultativ të Kartës Afrikane, Gjykata Afrikane mbi të Drejtat e Njeriut dhe të Njerëzve do të themelohet për të plotësuar punën e Komisionit Afrikan duke marrë vendime detyruese, të cilat mund të përfshijnë edhe kompensime për dëme.

Amerika

Komisioni Interamerikan mbi të drejtat e njeriut (KNADN- IACHR)

Inter-American Commission on Human Rights

1889 F Street, N.W.

Washington, D.C., 20006

Washington U.S.A.

Numri i telefonit: + 1 202 458 6002

Adresa e internetit: <http://www.cidh.org/defaultE.htm>

E-mail: cidhoea@oas.org

Gjuhët e punës: angleze, frënge, portugeze dhe spanjolle.

Lloji i programeve: monitorimi, kurset për të drejtat e njeriut; bursa pasuniversitare për të drejtat e njeriut

Grupi i synuar: universitetet; njerëzit vendës

Komisioni Interamerikan mbi të Drejtat e Njeriut është njëri nga të dy institucionet në sistemin ndër-amerikan për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Komisioni e ka selinë në Uashington, D.C. Institucion tjetër për të drejtat e njeriut është Gjykata Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut, e cila është e bazuar në San Jose, në Kostarikë. KDADN është një organ autonom i Organizatës së Shteteve Amerikane. KDADN ka parimin primar që të promovojë observimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në situata të përgjithshme të të drejtave të njeriut dhe në ankesave individuale. Çdo person, grup apo person apo organizatë joqeveritare mund të prezantojë një petition për Komisionin që pohon shkeljet e të drejtave dhe mbrojtjen e Konventës Amerikane të Deklaratës Amerikane.

Instituti Interamerikan mbi të Drejtat e Njeriut (INADN)

Interamerikan Institute of Human Rights (IIDH)

P.O. Box: 10081-1000

San Jose, Costa Rica

Numri i telefonit: Phone: (506) 234 04 04

Faqja e internetit: <http://www.iidh.ed.cr/>

Gjuhët e punës: angleze, spanjolle

Llojet e programeve: monitorimi; publikimet; kurset e ndryshme dhe trajnimit në mekanizmat rajonale dhe ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ligjin ndërkombëtar; ADN në shkollat e mesme

Grupet e synuara: Aktivistët e OJQ-ve, grupet profesionale, zyrtarët qeveritarë, mësuesit INADN punon për promovimin dhe arritjen e të drejtës së përmbyllur në Konventën Amerikane mbi të Drejtat e Njeriut, dhe që të ndihmojë për të konsoliduar demokracinë, përmes arsimit, hulumtimit, medimit politik, programeve të trajnimit, asistencës teknike mbi çështjet e ndërlidhura me të drejtat e njeriut, dhe përhapjen e diturisë nëpërmjet publikimeve të specializuara. Përpyekjet e INADN janë të udhëhequra nga parimet e

demokracisë përfaqësuese, sundimit të ligjit, pluralizmit ideologjik dhe respektit për të drejtat dhe liritë themelore. IDADN punon me Gjykatën Ndër –Amerikane dhe me Komisionin Inter- Amerikan mbi të Drejtat e Njeriut, të gjithë këta sektorë të shoqërisë civile dhe të shtetit në vendet e hemisferës perëndimore dhe organizatave ndërkombëtare.

EVROPA

Këshilli i Evropës (KE)

Council of Europe (CeO)

F-67075 Strasbourg Cedex

Strasbourg, France

Numri i telefonit: + 33 3 88 412 000

Adresa e internetit: www.coe.int

E-mail: ahr@coe.fr

Gjuhët e punës: angleze, frënge

Llojet e programeve: qendrat e dokumentimit; publikimet; trajnimet e mësuesve

Grupet e synuara: niveli i shkollave fillore dhe të mesme, grupet profesionale

Këshilli i Evropës mbulon të gjitha çështjet e mëdha në të cilat shoqëria evropiane pret

mbrojtje. Programet e tij të punës përfshijnë edhe këto fusha të veprimit: të drejtat e

njeriut, të drejtat mediale, bashkëpunimin juridik, kohezionin social, shëndetësinë,

arsimimin, kulturën, trashëgiminë, sportin, rininë, demokracinë lokale dhe

bashkëpunimin trans-kufitar, planifikimi i mjedisit dhe ai rajonal. Këshilli i Evropës nuk

duhet të përzihet me Këshillin e Bashkimit Evropian. Këto dy organizata janë shumë të

ndryshme. Megjithatë, 15 vendet e Bashkimit Evropian janë anëtarë të Këshillit të

Evropës, i cili ka 45 anëtarë.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

General OSCE contact

Kaerntner Ring 5-7, 4th Floor,

1010 Vienna, Austria

Numri i telefonit: +43 1 514 36 180

Adresa e internetit: www.osce.org

E-mail: info@osce.org

Gjuha e punës: angleze

OSBE është organizata rajonale e sigurisë, më e madhja në botë me 55 shtete anëtare nga Evropa, Azia Qendrore dhe Amerika Veriore. Është shumë aktive në fillimet e krizave, në parandalimin e krizave, menaxhimin e krizave dhe rehabilitimin post-konfliktual. Qasja e OSBE për sigurinë është gjithëpërfshirëse në lidhje me çështje të ndërlidhura me sigurinë, përfshirë kontrollin e armëve, diplomacinë parandaluese, masat për ndërtimin e besimit dhe të sigurisë, të drejtat e njeriut, demokratizimin, monitorimin e zgjedhjeve dhe sigurinë ekonomike dhe ambientale.

Zyrja për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut e OSBE (ZIDDN)

OSCE Office for Democratic Institutions and Human Rights (DIHR)

Aleje Ujazdowskie 19,

00-557 Warsaw, Poland

Numri i telefonit: +48 22 520 06 00

Adresa e internetit: www.osce.org/odihr

E-mail: office@odihr.pl

Gjuha e punës: angleze

ZIDDN është një institut primar i OSBE-së i besuar për dimensionin e të drejtave të njeriut.

ZIDDN promovon zgjedhjet demokratike nëpër ciklin e monitorimeve të thella të zgjedhjeve nacionale dhe i ndihmon projektet që kanë për qëllim forcimin e demokracisë dhe qeverisjen e mirë, duke shtuar kështu stabilitetin. Ofron mbështetje praktike në institutet e demokracisë në konsolidim dhe respekton të drejtat e njeriut, si dhe forcimin e shoqërisë civile. Për më shumë, shërben si pikë kontaktuese e OSBE për çështjet e Romës dhe Sinitis dhe së fundi kontribuon për paralajmërime të hershme dhe për parandalimin e konfliktit, duke monitoruar dhe zbatuar dimesionet njerëzore të zotimeve të OSBE.

OJQ

OJQ Ndërkombëtare

Lidhja Anti – Shpifëse (LASH)

Anti-Defamation League (ADL)

823 United Nation Platza, New York, NY 10017

Numri i telefonit: + 212 885 7805

Numri i faksit: + 212 885 5860

Adresa e internetit: www.adl.org

E-mail: webmaster@adl.org

Gjuha e punës: angleze

Llojet e programeve: Burimet e LASH për klasë dhe bashkësi; Ilojlojshmëria e shanseve interaktive trajnuese për profesionistët e fuqizimit të ligjit (trajnimi i ekstremizmit, trajnimi i krimit nga urrejtja dhe trajnimin kundët paragjykimeve); udhëzime për përgjigje ndaj krimit nga urrejtja; produksione filmike të studentëve

Grupet e synuara: fëmijët parashkollorë, filloristët, fëmijët e shkollave të mesme, ata të shkollave të larta, studentët, profesionistët e fuqizimit të ligjit (shoqëria civile si tërësi)

Amnesty International (AI)

1 Easton Street, London WCI 8Dj

United Kingdom, Europe

Numri i telefonit: + 44 20 742 335 00

Adresa e internetit: www.amnesty.org

E-mail: jluck@amnesty.org;

cthomas@amnesty.org

Gjuhët e punës: angleze, arabe, frënge, spanjolle

Llojet e programeve: zhvillimi i materialeve të ADN, materialet e mësimit; trajnimi për polici, ushtri dhe grupe të tjera profesionale

Grupet e synuara: nivelet e shkollave fillore dhe të mesme; grupet profesionale

Amnesty International është një lëvizje që bën fushata në të gjithë botën, që punon për promovimin e të drejtave të njeriut të njohura ndërkombëtarisht. Misioni i saj është që të

ndërmarr hulumtime dhe veprime të fokusuara në parandalimin e shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut të integritetit fizik dhe mental, lirinë e ndërgjegjes dhe të shprehurit, lirinë nga diskriminimi, me një kontekst të punës së tyre për promovimin e të gjitha të drejtave të njeriut. Amnesty International ka më shumë se një milion anëtarë dhe mbështetës, në më shumë se 144 vende.

Shoqëria e Arsimimit për të Drejtat e Njeriut (SHADN)

Human Rights Education Associates (HREA)

P.O. Box 382396, Cambridge

MA 02238 – 2396. USA

Numri i telefonit: + 1 617 625 0278

Adresa e internetit: www.hrea.org

E-mail: info@hrea.org

Gjuha e punës: angleze

Shoqëria e Arsimimit për të Drejtat e Njeriut (SHADN) është një organizatë ndërkombëtare joqeveritare që mbështet arsimimin për të drejtat e njeriut; trajnimin e aktivistëve dhe profesionistëve; zhvillimin e materialeve dhe programeve arsimore; dhe ndërtimin e bashkësive nëpërmjet teknologjisë së drejtëpërdrejtë (on-line). SHADN i është dedikuar arsimit dhe trajnimit kualitativ për të promovuar kuptimin, qëndrimet dhe veprimet për mbrojtje të të drejtave të njeriut, dhe të kujdeset për zhvillimin e bashkësive paqësore, të lira dhe të drejta.

Human Rights Watch

350 Fifth Avenue, 34th Floor

Neë York, NY 10118-3299, USA

Numri i telefonit: + 1 212 290 4700

Adresa e internetit: www.hrw.org

E-mail: hrwnyc@hrw.org

Gjuha e punës: angleze

Human Rights Watch është organizata më e madhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Hulumtuesit e Human Rights Watch-it bëjnë gjurmime për gjetjen e fakteve për shkelje të të drejtave të njeriut në të gjitha rajonet e botës. HRW pastaj boton të faktet në shumë libra dhe raporte vjetore, duke përfutur një mbulim medial të madh në mediat lokale dhe ndërkombëtare. Human Rights Watch pastaj takohet me zyrtarët e qeverisë për të nxitur ndryshime në politika dhe në praktikë.

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK)

International Committee of the Red Cross

19 avenue de la Paix

CH 1202 Geneva

Numri i telefonit: ++ 41 (22) 734 60 01

Adresa e internetit: www.icrc.org

E-mail: webmaster.gva@icrc.org

Gjuhët e punës: angleze, frënge, spanjolle

KNKK është një organizatë e paanshme, neutrale dhe e pavarur, misioni ekskluziv humanitar i të cilës është mbrojtja e jetëve dhe dinjitetit të viktimave në luftë apo në konflikte ndërkombëtare dhe që t'iu ofrojë atyre ndihmë. Ai udhëheq dhe koordionon aktivitetet ndërkombëtare të ndihmës, të cilat ndërmerren në situata të ndryshme të konfliktit. Po ashtu përpiqet të parandalojë vuajtjet, duke promovuar dhe forcuar parimet dhe zbatimet e ligjit humanitar.

Dekada e Njerëzve e Arsimimit për të Drejtat e Njeriut (DNADN)

People's Decade of Human Rights Education (PDHRE)

526 west 111th Street, Suite 4E

Neë York, NY 10025, USA

Numri i telefonit: + 1 212 749 3156

Adresa e internetit: <http://www.pdhre.org>

E-mail: pdhre@igc.apc.org

Llojet e programeve: qendra e burimeve për zhvillimin dhe hulumtimin e materialeve arsimore, trajnimi i popullatës së rritut, konferencat dhe ndërtimi i koalicioneve DNADN i sheh të drejtat e njeriut si një sistem të vlerave, i aftë për forcimin e bashkësive demokratike dhe të kombeve përmes theksimit të përgjegjësisë, reciprocitetit, dhe pjesëmarrjes së barabartë dhe të informuar të njerëzve në vendimarrjen, e cila ndikon në jetën e tyre. DNADN ishte kryesore në lobimin në Kombet e Bashkuara që të shpallet Dekada për Arsimim për të Drejtat e Njeriut dhe për skicimin e lobimit për rezoluta të ndryshme nga Konferenca Botërore mbi Arsiminim për të Drejtat e Njeriut, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Instrumentet e Traktateve të KB dhe Konferenca e Katërt Botërore mbi Femrat.

Asociacioni Botërore për Shkollën si një Instrument të Paqes (EIP)

World Association for the School as an Instrument for Peace (EIP)

5, Rue de Simpson

CH-1207 Geneva,

Switzerland, Europe

Numri i telefonit: + 41 22 7352422 (faks)

Adresa e internetit: <http://www.epi-cifedhop.org/>

E-mail: cifedhop@mail-box.ch

Llojet e programeve: Qendra Ndërkombëtare e Trajnimeve mbi të Drejtat e Njeriut dhe Sjelljes së Paqes (CIFEDHOP); me seksionet gjuhësore të anglishtes, frëngjishtes dhe spanjishtes

Grupi i synuar: edukatorët e të drejtave të njeriut

EIP përkujdeset për aktivitetet në fushën e të arsimimit për të drejtat e njeriut, paqe dhe qytetari. EIP ka kontribuar anëmbanë botës për vetëdijësimin e rretheve arsimore, autoritetet qeveritare dhe shoqërinë civile, për nevojën e një arsimimi të tillë në shkolla dhe në bashkësi. Kështu, EIP propozon aktivitete të trajnimit për mësues, përmbajtjen dhe strategjinë e kurrikulës, si dhe veprime specifike që i kontribuojnë zhvillimit të

qëndrimeve, aftësive dhe diturisë për përmirësimin e të drejtave të njeriut, lirive themelore, dhe zgjidhjen e konflikteve pa dhunë.

OJQ Rajonale

Afrika dhe Lindja e Mesme

Të Drejtat Afrikane

African Rights

Drejtor: Rakiya Omaar

P.O.Box 18368

London EC4 A 4JE

England / U.K.

Numri i telefonit: + 44 (0) 20 7947 3276, Faksi + 44 (0) 20 7947 3253

Llojet e programeve: Të Drejtat Afrikane është një organizatë e dedikuar të punojë në çështjet e shkeljes së rëndë të të drejtave të njeriut, si konflikti, uria, dhe rikonstruimi civil në Afrikë. Të Drejtat Afrikane bën gjurmime dhe hulumtime mbi shkeljet e të drejtave të njeriut në mënyrë të veçantë në Ruandë, Somali dhe Sudan dhe mund të identifikojë strukturat dhe përbërjet e një paqeje të përleshme dhe të rrëgjimit të vazhdueshëm të të drejtave të njeriut.

Afronet

P.O. Box 31145

Lusaka, Zambia

Numri i telefonit: + 260 1 251813/4

Faksi: + 260 1 251776

Adresa e internetit: <http://www.afronet.org.za>

E-mail: info@afronet.org.za

Llojet e programeve: Afronet është e përkushtuar që të ndihmojë ndërlidhjen dhe bashkëpunimin në mes organizatave joqeveritare në Afrikë. Ajo ndërmerr programe të lehtësimit dhe zbatimit të Kartës Afrikane mbi të Drejtat e Njeriut dhe të njerëzve nga

shtetet afrikane dhe të traktateve dhe instrumenteve të tjera rajonale të miratura nga shtetet afrikane për përmirësimin e standardeve të jetesës dhe sfidon korrupsionin nga programet ndihmëse të fuqizimit dhe pjesëmarrjes popullore, për të siguruar sigurinë publike në të gjitha nivelet e shoqërisë afrikane.

Instituti Arab për të Drejta të Njeriut (IADN)

Arab Instituiton for Human Rights (AIHR)

10, rue IBN Masoud

El Manzah, 1004 Tunis, Tunisia

Numri i telefonit: + 216 1 767 889 / 767 003

Adresa e internetit: www.aihr.org.tn

E-mail: aihr.infocenter@gnet.tn

Gjuhët e punës: angleze, frënge dhe arabe

Lloji i programeve: programe të ndryshme trajnuese për OJQ-të e të drejtave të njeriut; kurse për të drejtat e njeriut për studentët universitarë; dokumentimi; hulumtimi

Grupet e synuara: anëtarët e OJQ; grupet profesioniste; mësuesit, studentët, fëmijët; femrat.

Instituti Arab për të Drejta të Njeriut (IADN) është një OJQ e pavarur arabe e themeluar në vitin 1989. Instituti ka për synim ngritjen e ndërgjegjes mbi të drejtat politike, kulturore, sociale dhe ekonomike. Po ashtu, ka për qëllim të përhapë dhe të promovojë arsimimin për të drejtat e njeriut nëpërmjet seminareve, praktikumeve, hulumtimeve, hulumtimeve mbi të drejtat e femrës, të drejtat e fëmijës etj.

Instituit i Kajros për Studime mbi të Drejtat e Njeriut (IKSDN)

Cairo Institute for Human Rights Studies (CIHRS)

P.O. Box 117

Maglis El Shaab

Cairo, Egypt

Numri i telefonit: + 2002 354 – 3715

Adresa e internetit: <http://www.cihrs.org/>

E-mail: cihrs@idsc.gov.eg

Llojet e programeve: hulumtim, trajnimi i trajnuesve, trajnim mbi Konventat e Eliminimit të të Gjitha Formave të Diskriminimit kundrejt Gruas (KEGJFDKG) dhe Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve; Klubin Kinematografik për të Drejtat e Njeriut; trajnimin rajonal vjetor arab; kursin e përvjetshëm veror për studentët e universitetit mbi të drejtat e njeriut.

Grupet e synuara: OJQ e të drejtave të njeriut, shtëpitë fetare, femrat, mësuesit.

Gjuhët e punës: arabe, angleze

IKSDN është një qendër hulumtuese e specializuar në fushën e të drejtave të njeriut. Detyra kryesore është që të analizojë dhe shpjegojë pengesat që dalin nga procesi i zbatimit të të drejtave të njeriut në botën arabe. Orvatet që të promovojë të drejtat e njeriut në vendet arabe, nëpërmjet zhvillimit të fuqishëm intelektual dhe qasjeve të reja për tejkalimin e problemeve të zbatimit të këtyre të drejtave.

Instituti për të Drejtat e Njeriut dhe Zhvillim në Afrikë

Institute for Human Rights and Development in Afrika

P.O. Box 1896

Banjul

Gambia

Numri i telefonit: + 220 496421,

Faksi: + 220 494 178

Adresa e internetit: www.africaninstitute.org

E-mail: onfo@africaninstitute.org

[Qëllimi i këtij instituti është që të kontibujë për të drejtat e njeriut dhe zhvillim në Afrikë, duke përdorur traktatet e të drejtave të njeriut afrikan, dhe në veçanti Kartës Afrikane mbi të Drejtat e Njeriut dhe të Njerëzve. Po ashtu shërben si një këshillimore për individët dhe OJQ-të, duke mbrojtur në gjyq rastet e tyre kundër palëve shtetërore përballë Komisionit Afrikan.](#)

Avokatët për të Drejtat e Njeriut

Lawyers for Human Rights (LHR)

National Office, Kultwanong Democracy Centre

357 Visagie Street (cnr. Prinsloo Street)

Pretoria 0002, South Afrika

Numri i telefonit: + 27 12 320 1943 (faks)

Adresa e internetit: <http://www.lhr.org.za>

E-mail: lhr@lhr.org.za

Llojet e programeve: arsimim vullnetar, këshillime juridike, mbrojtje në gjyq, trajnim parajuridik, reforma penale, reforma ligjore; të drejtat e refugjatëve, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e femrave,

Grupet e synuara: grupet profesioniste; nivelet e shkollave të mesme; zyrtarët publikë; publiku i përgjithshëm

Vendet: Afrika Jugore, Republika Jugafrikane, Afrika e Nënshaharësë

Avokatët për të Drejtat e Njeriut është një organizatë joqeveritare dhe joprofitabile, vizioni i të cilës është që të jetë organizata kryesore për të drejtat e njeriut, mbrojtëse e kushtetushmërisë dhe për avokim; një forcë ndërkombëtare për zhvillimin dhe shpërndarjen e të drejtave të njeriut, me një përqendrim parësor në Afrikë, dhe të jetë kontribues primar për pastrimin e politikave strategjike mbi zhvillimin e të drejtave socio-ekonomike për të paavancuarit. LHR shpejt ka arritur një dosje të mirë për luftën kundër shtypjes dhe shkeljen e të drejtave të njeriut nën aparteid. LHR më vonë ka ndihmuar punonjësit e gjyqeve në tranzicion drejt demokracisë nëpërmjet arsimimit të votuesve dhe monitorimit.

Azia dhe Paqësori

Qendra Rajonale e Burimeve të Azisë për Arsimim mbi të Drejtat e Njeriut (QRBAADN)

Asian Regional Resource Center for Human Rights education (ARRCHR)

2738 Ladprao, 128/3 Klongchan, Bangkok

Bangkok 10240, Thailand

Numri i telefonit: + 66 2 377 5641

Adresa e Internetit: www.arcc-hre.com/

E-mail: arcc@ksc.th.com

Gjuhët e punës: angleze

Llojet e programeve: shtëpi mbledhëse dhe publikuese e materialeve të ADN në rajonin e Azisë dhe Paqësorit; trajnimin e trajnuesve në ADN; arsimimi popullor

Grupet e synuara: arsimimi zyrtar; arsimimi jozyrtar; grupet profesionistë:

QRBAADN synon që të popullarizojë insitucionalizimin e arsimimit për të drejtat e njeriut në rajonin e Azisë-Paqësorit. Ajo punon drejt mobilizimit të njerëzve që të marrin pjesë në transformimin e ndieshëm të shoqërisë drejt të drejtave të njeriut dhe në kulturën e paqes, demokracisë dhe drejtësisë.

QRBAADN shërben si institut i një rrjeti të arsimimit për të drejtat e njeriut në rajonin Azi-Paqësor, duke formuar trajnim për të drejtat e njeriut, praktikume, zhvillim dhe shkëmbim i materialeve institucionale dhe të tjera, si dhe hulumtim dhe fushata për ADN.

Komisioni Aziatik i të Drejtave të Njeriut (KAzDN)

Asian Human Rights Commission & Asian Legal Resource Centre

Unit D, 7th floor, Mongkok Commercial Centre,

16-16B Argyle Street, Kowloon

Hing Kong, Republic of China

Numri i telefonit: + 852 2698 6339

Adresa e internetit: <http://www.ahrchk.org>

E-mail: ahrchk@ahrchk.org

Gjuhët e punës: angleze, hungareze

Llojet e programeve: arsimimi në nivele lokale për promovimin e vetëdijësimin për të drejtat e njeriut; raportimi; monitorimi; shkëmbimi

Grupet e synuara: grupet e bashkësisë, OJQ, profesionistët, studentët

KazDN është themeluar në vitin 1986 nga një grup i mirënjohur i juristëve dhe aktivistëve të të drejtave të njeriut të Azisë. KazDN është një institucion i pavarur joqeveritar, i cili synon të promovojë vetëdijësimin më të madh dhe realizim të të

drejtave të njeriut në rajonin e Azisë, si dhe që ta mobilizojë opinionin publik aziatik ndërkombëtar për të marrë ndihmë dhe kompensim për viktimat e shkeljes së të drejtave të njeriut. KazDN promovon të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. KazDN orvatet që të arrijë pikësynimet e deklaruara në Kartën Aziatike.

Evropa

Qendra Daneze për të Drejtat e Njeriut

Danish Centre for Human Rights

Grundtvigs Hus

Studivestergade 38

DK-1455 Copenhagen K, Denmark

Numri i telefonit: +45 33 30 88 68,

Faksi: + 45 33 30 88 00

E-mail: DB@humanrights.dk

Adresa e internetit: www.humanrights.dk/

Qëllimi i kësaj qendre është të grumbullojë dhe ta zhvillojë dijen për të drejtat e njeriut në shkallë nacionale, rajonale dhe ndërkombëtare. Puna e kësaj qendër përfshin hulumtimet, informimin dhe botimin, arsimimin, dokumentimin dhe projektet ndërdisiplinare. Punëtorët e kësaj organizate përfaqësojnë një shkallë të gjerë të disiplinave si ligji, antropologjia, sociologjia, ekonomia, historia dhe gazetaria. Që nga viti 1999 është një këshilltar i lartë i cili punon për të drejtat e njeriut, të femrave dhe të drejtat e lindjes. Qendra bashkëpunon me organizatat joqeveritare dhe me autoritetet publike në shkallë nacionale dhe ndërkombëtare. Po ashtu bashkëpunon me Këshillin Nordik, Këshillin e Evropës, OSBE, BE dhe KB.

Fondacioni i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (FHFN)

Helsinki Foundation for Human Rights (HFHR)

18 Bracka Steet apt. 62

00-028 Warsaw, Poland

Numri i telefonit: + 48 22 828 10 08 / 828 69 96

Adresa e internetit: www.hfhrpol.waw.pl/en/index.html

E-mail: hfhr@hfhrpol.waw.pl

Gjuha e punës: angleze

Llojet e programeve: arsimimi dhe trajnimi për të drejtat e njeriut për grupe profesioniste; Shkolla e të drejtave të njeriut: fushata publike e arsimimit; monitorimi; iniciativat legjislative.

Grupet e synuara: avokatët, parlamentarët, udhëheqësit e OJQ, gazetarët, gjykatësit, policët, punëtorët e burgjeve.

Fondacioni i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (FHDN) është një organizatë joqeveritare e pavarur nga shteti apo nga partitë politike, i kyçur në aktivitet ndërkombëtare për arsimin mbi të drejta të njeriut, sundimin e ligjit dhe kushtetushmërinë e personave të ndërlidhur me organizatat joqeveritare, ishtitucionet shtetërore dhe mediat. Fondacioni i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (FHDN) po ashtu mëson veprimet efektive për mbrojtje dhe promovim të të drejtave të njeriut.

Federata Ndërkombëtare e Helsinkit (FNH)

International Helsinki Federation (IHF)

Rummelhardtgasse 2/18

A-1090 Vienna, Austria

Numri i telefonit: + 43 1 408 88 22

Adresa e internetit: www.ihf-hr.org

Gjuha e punës: angleze

Llojet e programeve: trajnimi i grupeve profesioniste; monitorimi i situatave të të drejtave të njeriut.

Grupet e synuara: anëtarët e organizatave të FNH; gjyqësori, vendet aktiviste për të drejtat e njeriut: shtetet anëtare të OSBE.

Federata Ndërkombëtare e Helsinkit (FNH) për të Drejtat e Njeriut është një grup vetëqeverisës i një organizata joprofitabile, joqeveritare që vepron për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në të gjithë Evropën, Amerikën Veriore, dhe republikat e Azisë Qendrore të formuara nga territoret e ish-Bashkimit Sovjetik. Qëllimi primar është që të monitorojë harmonizimin me konditat e Aktit të Final të Helsinikut dhe dokumentet e

tjera në vazhdim. Sekretariati i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit (FNH) gjendet në Vijenë dhe mbështet e ofron lidhje dhe komunikim me dyzet e një anëtarët e “Komiteteve të Helsinikit”, i ndërlidh grupet e të drejtave të njeriut dhe i përfaqëson ata në nivel politik ndërkombëtar. Federata Ndërkombëtare e Helsinkit (FNH) po ashtu ka lidhje direkte me individë dhe grupe që mbështetin të drejtat e njeriut ku nuk ka asnjë komitet të Helsinikit.

Instituti i të Drejtave të Njeriut dhe Ligjit Humanitar Raul Uallenberg

Raoul Wallenberg Institute of Human Rights and Humanitarian Law

P.O. Box 1155

S-22105 Lund

Sweden

Tel: + 46 46 222 12 08

Faksi: + 46 46 222 12 22

Adresa e internetit: <http://www.rwi.lu.se>

E-mail: secretariat@rwi.lu.se

Instituti i të Drejtave të Njeriut dhe Ligjit Humanitar Raul Uallenberg është një institut akademik i formuar në vitin 1984 në Fakultetin Juridik të Universitetit të Lundit në Suedi. Qëllimi i këtij instituti është që të promovojë hulumtimin, trajnimin dhe arsimimin akademik në fushat e të drejtave të njeriut dhe ligjit humanitar.

Amerika Latine

Komisioni për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Amerikën Qendrore (KMDNA)

Comision para Defensa de los Derechos Humanos en Centroamerica (CODEHUCA)

189-1002, San Jose, Costa Rica

Numri i telefonit: + 506 224 59 70

Adresa e internetit: www.codehuca.or.cr/

e-mail: codehuca@codehuca.or.cr

Gjuhët e punës: angleze, spanjolle

Komisioni për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Amerikën Qendrore (KMDNA) është një asociacion i pavarur rajonal, joprofitabil, joqeveritar dhe joreligjioz. Që nga themelimi në vitin 1978 është bërë një institucion që vepron në shoqërinë civile të Amerikës Qendrore. Qëllimi më i rëndësishëm i **KMDNA** është që të ndihmojë rritjen e respektit për të drejtat e njeriut në Amerikën Qendrore. Për ta arritur këtë qëllim, asociacion zhvillon dhe vë në praktikë një koncept të integruar të të drejtave të njeriut, thellon konceptin e të drejtave të njeriut në Amerikën Qendrore, thekson parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe mbështet sektorët më të cenuar të shoqërisë së Amerikës Qendrore.

PROGRAMET E MAGJISTRATURËS PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Programet e Magjistraturës Evropiane në të Drejta të Njeriut dhe Demokratizim

European Inter-University Centre (EIUC) për të Drejtat e Njeriut dhe Demokratizim
E.MA Secretariat: Monastery of San Nicolo, Riviera San Nicolo, 26, I-30126 Venice-
The Lido

Tel: + 39 041 2720 923 (direkt)

Tel: + 39 041 27 20 911 (sekretariati)

E-mail: ema-info@venis.it, secretariat@ema-humanrights.org

<http://hred-euromaster.venis.it>

Programet e Magjistraturës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Demokratizim në Evropën Juglindore

Qendra për Studime Ndërdisciplinare për Studime Postdiplomike e Universitetit të
Sarajevës, Obala Kulina bana 7/1. 71 000 Sarajevo, Bosnja dhe Hercegovina

Tel: + 387 33 668 685

E-mail: coordination@cps.edu.ba, law@cps.edu.ba

<http://www.eurobalk.net>

Magjistratura Mesdhetare në të Drejtat e Njeriut dhe Demokratizim

Universitetit i Maltës

Old University Building, St, Paul Street, Valletta

VLT 07, Malta

Tel: (356) 242791, 234121 ext 242

E-mail: grights@maltanet.net

<http://home.um.edu.mt/laws/test/hrd/>

Magjistratura Afrikane në të Drejtat e Njeriut dhe Demokratizim

Qendra për të Drejtat e Njeriut, Universiteti i Pretorias,

PRETORIA 0002, Afrika Jugore

Tel: + 27 12 420 3228

E-Mail: chheyns@hakuna.up.ac.za

<http://www.up.ac.za/chr/neemasters/masters.html>

E-mail: awpgs@hkusua.hku.hk

Magjistratura Aziatike në të Drejtat e Njeriut

Qendra për Ligjin e Krahasuar dhe Publik

Centre for Comparative and Public Law, 4th floor K.K. Leung Building, Pokfulam Road,

University of Hong Kong (Universiteti i Hong Kongut)

Tel: awgs@hkusua.hku.hk

<http://www.hku.hk/ccpl/hr-programs/i>

Programi Postdiplomik në Ligjin e të Drejtave të Njeriut dhe Studimet për të Drejtat e Njeriut

Universiteti i Paqes, Apdo. 138-6100, Ciudad Colon, Costa Rica

Tel: + 506 205 9000

E-mail: acadmin@upeace.org

http://www.upeace.org/academic/masters/int_law.htm

Programi i Magjistraturës në Ligjin e të Drejtave të Njeriut dhe Demokratizim i Institutit Raul Uallenberg

Faculty of Law, University of Lund,

Box 207, SE-221 00 LUND, Sweden

Tel: + 46 46 222 1249

E-mail: frida.ericmats@jur.lu.se apo frida.nilsson@jur.lu.se

<http://www.rwi.lu.se/>